


01-2175



Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt. 20.02.2008 nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr.391/02-266081/22 dt. 09.12.2022, të pronarit/investitorit Qazim Asllanaj nga Prishtina me adresë rr. “Nazmi Pacolli” nr. 32, Matiçan në Prishtinë, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, të ndërtesës së banimit/ shtëpi individuale e banimit me etazhitet B+P+1, e ndërtuar në kuadër të Planit Zhvillimor Urban - PZHU në Prishtinë, në parcelën kadastrale 00124-3 ZK Matiçan, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë të rregullt administrative, me datën 27.10.2023, lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LËSHOHET Certifikata e përdorimit pronarit/investitorit Qazim Asllanaj nga Prishtina me adresë rr. “Nazmi Pacolli” nr. 32, sipas kërkesës 05 Nr.391/02-266081/22 dt. 09.12.2022, për përdorimin e ndërtesës së banimit/ shtëpi individuale e banimit me etazhitet B+P+1, e ndërtuar në kuadër të Planit Zhvillimor Urban - PZHU në Prishtinë, në parcelën kadastrale 00124-3 ZK Matiçan, sipas Vendimit 05 Nr.351/02-248830/19 dt. 14.01.2020, për lejimin e ndërtimit të ndërtesës.

II. Ndërtesa, mund të përdoret, sipas destinimit të përcaktuar në pikën I. të Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr.351/02-248830/19 dt. 14.01.2020, dokumentacionit ndërtimor dhe Inspektimit Final, të lëshuar nga Drejtoria e Inspektionit të Komunës së Prishtinës, Sektori i Ndërtimit.

III. Ndërtesa gjendet në rr. “Nazmi Pacolli” nr. 32 në Matiçan - Prishtinë.

IV. Ndërtesa mund të përdoret nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate.

V. Kjo Certificate shërben për regjistrimin e ndërtesës në regjistrin kadastral të përshkruar në pikën I. të këtij vendimi.

VI. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH. Nr. 05/2017 për Mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

A r s y e t i m

Pronari/investitori Qazim Asllanaj nga Prishtina me adresë rr. “Nazmi Pacolli” nr. 32, me kërkesën 05 Nr.391/02-266081/22 dt. 09.12.2022, ka kërkuar nga kjo drejtori, lëshimin e certifikatës së përdorimit të ndërtesës së banimit/ shtëpi individuale e banimit me etazhitet B+P+1, në lokacionin e përshkruar si në pikën I. të dispozitivit të kësaj certificate.

Drejtoria e Inspektionit-Sektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës përmes shkresës zyrtare “Njoftim mbi inspektimin final me referencë 09 Nr.391/02-89312/22 dt. 05.10.2022 ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizmit, Raportin e Inspektimit final të punëve dhe përshkrimit të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspektionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, pronari/investitori ka prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit:

- Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit shtojca 2 dhe 4/a deri 4/f.
- Vendimin nr. 05 Nr.351/02-248830/19 dt. 14.01.2020 për lejimin e ndërtimit të ndërtesës së banimit/ shtëpi individuale e banimit me etazhitet B+P+1 në parcelën kadastrale nr. 00124-3 ZK Matiçan.
- Dispozita urbanistike e objektit me parcelën kadastrale në sistemin Kosovaref01.
- Aktvendimin me nr. 05 Nr.351/02-248830/19 dt. 25.11.2019, mbi caktimin e taksës administrative për lejen e ndërtimit dhe tarifën për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës.
- Informim mbi caktimin e adresës për ndërtesën me nr. të “letër informuese për adresën zyrtare” 0004019, rr. “Nazmi Pacolli” nr. 32 në Matiçan - Prishtinë.

- Raportin e mbikëqyrjes profesionale për secilën nga fazat e projektit si dhe raportin e udhëheqësit të punishtes, Agon Fazliu bsc. - udhëheqës i vendndërtimit, Marigona Asllanaj bsc. - mbikëqyrëse për arkitekturë, Egzon Elshani bsc. - mbikëqyrës për strukturë, Alban Zubaku bsc. - mbikëqyrës për hidro-instalime, Enis Krasniqi bsc. - mbikëqyrës për instalime elektrike, Agim Krasniqi idm - mbikëqyrës për instalime makinerike.
- Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti i licencuar Ibrahim Junuzi me nr. të licencës 105.
- Protokollin e miratuar për të gjitha fazat e ndërtimit,
- Atestet e materialeve dhe rezultatet e testimeve,
- Fotografijë gjatë procesit të ndërtimit,
- Kopjet e diplomave të inxhinierëve mbikëqyrës të objektit,
- Çertifikata e pronës dhe kopja e planit

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, konkretisht shkresës zyrtare “Njoftimi mbi Inspektimin Final të ndërtimit të ndërtesave”, i prezentuar nga Drejtoria e Inspektionit Sektori i Ndërtimit, me referencë 09 Nr.391/02-89312/22 dt. 05.10.2022, dhe pas dorëzimit të dokumentacionit nga ana e investitorit, përmes kërkesës Nr.391/02-266081/22 dt. 09.12.2022, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve mbikëqyrës të fazave të ndërtesës: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, dhe punëve zëjtare si dhe matjeve gjeodezike, konstatohet se ndërtesa është realizuar në përputhshmëri të plotë me Ligjin e Ndërtimit Nr. 04/L-110, projektin kryesor, Lejen ndërtimore nr. 05 Nr.351/02-248830/19 dt. 14.01.2020. Po ashtu theksohet se punët janë zhvilluar në harmoni me projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa e banimit/ shtëpi individuale e banimit me etazhitet B+P+1, mund të përdoret.

Në Njoftimin mbi Inspektimin final të lëshuar nga Drejtoria e Inspektionit-Sektorit i Ndërtimit, është konstatuar se të gjitha punimet në ndërtesë janë të përfunduara, dhe se udhëzohet pala që të vazhdojë procedurat për pajisje me certifikatë të përdorimit. Po ashtu edhe kërkesat që dalin nga Ligji për Ndërtim Nr.04/L-110, neni 27, janë të aprovuara nga ana e Mbikëqyrjes Profesionale të angazhuar nga ana e Poseduesit të Lejes Ndërtimore.

Kjo drejtori, bazuar në raportet e prezantuar dhe konstatimet e lartcekura, vendosi që ndërtesa e banimit/ shtëpi individuale e banimit me etazhitet B+P+1, mund të përdoret/shfrytëzohet, gjegjësisht të lëshojë certifikatën e përdorimit për këtë ndërtesë.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certifikatë, me ankesë mund të drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja.

I dorëzohet: Kërkesit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspektionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR.391/02-266081/22 DT. 27.10.2023**

Zyrtari:

Arbër Morina